



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës NR. 06/L-092, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 3 prill 2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes bën këtë:

**FTESË PUBLIKE
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES
NGA SHOQËRIA CIVILE
(VAZHDIM I AFATIT PËR APLIKIM)**

Ftohen përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare - Shoqërisë civile të cilat veprojnë dhe kanë selinë në territorin e Komunës së Lipjanit, të dërgojnë propozimet e tyre për anëtarësim në Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës përkitazi me Propozim- Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ZK Lipjan Nr.15-463/02-17208 të datës 29.03.2024 **pasi është vazhduar afati për aplikim.**

Numri kërkuar : **1 (një) anëtarë** nga Shoqëria civile.

Propozimet sipas mundësisë duhet të përfshijë personat me prioritet nga lëmi i shkencave juridike, ekonomike, bujqësore apo të ndonjë lëmie tjetër të pregaditjes superiore.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për shërbime për qytetarë brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të kësaj ftese publike.

Ftesa të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 020/04-21386/2

Më datë: 25.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

